



## PËRDITËSIM

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, palët iu përgjigjën me shkrim urdhrin të Gjykatësit të Procedurës Paraprake i cili u kishte kërkuar të dorëzonin parashtrime me shkrim në kuadër të përgatitjes për konferencën e nesërme për ecurinë e çështjes.

Prokuroria dhe ekipet e Mbrojtjes deklaruan se nuk parashikojnë të hasin ndonjë vështirësi për kalimin e çështjes te trupi gjyqësor rreth fundit të vitit, në pritje të përfundimit të disa hapave proceduralë.

Prokuroria parashtrori më tej se nuk parashikon të hasë ndonjë vështirësi për dorëzimin deri më 18 nëntor 2022 të listës me 40 dëshmitarët e parë që do të thirren gjatë gjyqimit.

Konferenca për ecurinë e çështjes, ku do të diskutohen këto dhe aspekte të tjera, do të mbahet nesër, më 4 nëntor, në orën 13:30 dhe mund të ndiqet nga galeria për publikun ose në faqen e internetit të DHSK-së.

Dëshirojmë të rikujtojmë se z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi u arrestuan në nëntor 2020 në bazë të një aktakuze që ishte konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake *përpara* arrestimit të tyre, bazuar në fletarrestimet e lëshuara për secilin prej tyre.

Në lidhje me një temë tjetër: Gjykatësi i Vetëm në një çështje që lidhet me z. Driton Lajçi, rrëzoi kërkesën e dytë të Mbrojtjes për të urdhëruar ZPS-në të ndërpresë hetimin kundër z. Lajçi. Gjykatësi i Vetëm nuk e vlerësoi kohëzgjatjen e hetimit kundër z. Lajçi si të paarsyeshme, duke marrë parasysh kompleksitetin e tij.

Gjykatësi i Vetëm deklaroi më tej në vendimin e tij se Prokuroria nuk ka detyrim t'i japë z. Lajçi përditësime të rregullta mbi ecurinë e hetimeve të ZPS-së kundër tij.

Ndër lajme të tjera: këtë javë ekipi i Programit për komunikim dhe ndërgjegjësim i DHSK-së u takua me studentë të fakultetit të drejtësisë dhe gazetarë në Prishtinë, si dhe me nxënës të shkollës së mesme në Ferizaj.

### Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

1

